



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 30/2026
Datë: 08/05/2026

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), nenit 11, nenit 29 dhe nenit 30 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencie të Pavarura, në bazë të nenit 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 12/2023 mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore, si dhe në pajtim me nenin 6 të Rregullores (QRK) - Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Zëvendëskryeministrja dhe Ministrija e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Deklarata e Performancës së Avokaturës Shtetërore për vitin 2025.
2. Deklarata e Performancës publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.
3. Obligohet Njësia Përgjegjëse të dërgojë një kopje të Deklaratës së Performancës në Sekretariatit Koordinues të Qeverisë.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Donika Gërvalla - Schwarz



**Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë
në detyrë**

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Anëtareve të njësive përgjegjëse për mbikëqyrje të Avokaturës Shtetërore;
- Drejtorit të Avokaturës Shtetërore;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.

DEKLARATA E PERFORMANCES

Data:	08.05.2026
AGJENCIA	AVOKATURA SHETETETËRORE
MINISTRIA PËRGJEGJËSE	MINISTRIA E DREJTËSISË
Miratimi i Raportit të Performancës (Po/Jo)	Nga të dhënat e raportuara rezulton se pjesa më e madhe e objektivave të planifikuara për vitin 2025 janë realizuar me sukses. Për secilin indikator është evidentuar niveli i realizimit, ku shumica e tyre figurojnë të përmbushura. Mbi këtë, mund të konstatohet se Raporti i Performancës është i përgatitur në mënyrë të plotë dhe përfaqëson në mënyrë të saktë nivelin e zbatimit të objektivave për vitin 2025. Andaj, mund të konsiderohet se Raporti i Performancës, Po, është miratuar.
Vlerësimi përshkrues i Performancës	
Vlerësimi i performancës së Avokaturës Shtetërore (në tekstin e mëtejshëm referuar si: "AVSH") bazohet në Planin e Performancës për vitin 2025 dhe Raportin e Performancës së këtij plani. Ky plan përfshin gjithsej pesë objektiva konkrete si më poshtë: 1. Hartimi i Projekt-Rregullores për Organizim të Brendshëm dhe Funksionimin e Avokaturës Shtetërore 2. Ngritja e kapaciteteve të AVSH-së përmes trajnimeve profesionale për avokatët shtetëror 3. Rekrutimi i avokatëve shtetëror dhe stafit mbështetës në AVSH 4. Avancimi i bazës së të dhënave 5. Hartimi i Raportit Vjetor Të dhënat e paraqitura në raport dëshmojnë përkushtim të vazhdueshëm në përmbushjen e misionit ligjor të agjencisë, në përputhje me objektivat e Qeverisë për ndërtimin e një sistemi funksional, efikas dhe profesional. Ky progres është reflektuar edhe në rezultatet e arritura në fushën e arbitrazhit, duke treguar përmirësim të kapaciteteve institucionale dhe performancës profesionale. Në aspektin e funksionimit, AVSH ka treguar përkushtim përmes përfaqësimit të institucioneve në procedurat gjyqësore. Avokatura Shtetërore gjatë periudhës kohore janar- dhjetor 2025 , ka pranuar 12266 raste të Procedurës Kontestimore, Jokontestimore, Përmbartimore, Administrative dhe Penale, si: • Lënde në procedure kontestimore : 7937; • Lënde në procedure administrative: 3187;	

- *Lënde në procedure penale: 323;*
- *Lënde në procedure përmbarimore: 52;*
- *Lënde në procedure jo kontestimore: 767.*

Ka pranuar gjithsej 9343 thirrje për ta përfaqësuar Qeverinë e Republikës së Kosovës në seanca gjyqësore dhe 4692 (aktgjykime dhe aktvendime gjyqësore).

Ka përgatitur dhe përcjellë nëpër gjykatat e Republikës së Kosovës:

- *10100 përgjigje ne padi;*
- *650 parashitresa;*
- *816 ankesa;*
- *130 padi;*
- *5 revizione;*
- *52 prapësime*

Avokatura shtetërore ka qenë e mbingarkuar me punë, duke pasur parasysh se në sistemin e të dhënave janë të regjistruar gjithsej 12266 lëndë, nga të cilat rreth 30% janë të përfunduara, ndërsa të gjitha veprimet ndërmerren nga 15 avokatë shtetëror dhe 2 zyrtarë të larta ligjore dhe 2 konsulente.


Përkundër ngarkesës me lëndë, AVSH për vitin 2025, reflekton një nivel të kënaqshëm të zbatimit të objektivave strategjike, me theks të veçantë në forcimin e kornizës legjislative, e cila ndikon drejtpërdrejt në fuqizimin strukturor dhe funksional të institucionit. Në këtë drejtim, një hap i rëndësishëm ka qenë hartimi i Projekt-Rregullores për organizimin e brendshëm dhe funksionimin e Avokaturës Shtetërore, e cila synon rritjen e efikasitetit dhe qartësimin e përgjegjësiave institucionale.

- Grafiku më poshtë paraqet shkallën e realizimit të objektivave të Planit të Performancës së Avokaturës Shtetërore të Kosovës për vitin 2025.

Niveli i realizimit të Planit të Performancës së AVSH për vitin 2025

AVSH

E Kuqe-vonë me
veshtirësi të mëdha
20%



Te Realizuara
80%

Fushat me performancë të mirë

Disa nga fushat kanë qenë më të suksesshme, e këto përfshijnë:

- **Hartimi i Projekt-Rregullores për Organizimin e brendshëm dhe funksionimin e Avokaturës Shtetërore**

AVSH ka hartuar Projekt-Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe funksionimin e institucionit, me qëllim rritjen e efikasitetit, qartësimin e strukturës organizative dhe forcimin e funksionimit institucional. Kjo projekt-rregullore është proceduar për hapat e mëtejshëm të miratimit më 13 janar 2026.

- **Trajnimet profesionale për avokatët shtetëror**

Kjo objektivë është realizuar me sukses, pasi nga gjithsej 6 trajnime të parapara në Planin e Performancës, janë organizuar gjithsej 5 trajnime. Trajnimet janë realizuar nga GIZ, për Avokatët Shtetërorë, me fokus në investimet e huaja dhe arbitrazhin, si dhe nga Këshilli i Evropës, me temën e zbatimit të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Në këto trajnime kanë marrë pjesë 14 Avokatë Shtetërorë nga gjithsej 15 avokatë të angazhuar në institucion, duke kontribuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe forcimin e njohurive në fusha me rëndësi për punën e Avokaturës Shtetërore.

- **Rekrutimi i avokatëve shtetëror dhe stafit mbështetës në Avokaturën Shtetërore**

Kapacitetet e Avokaturës Shtetërore janë forcuar edhe përmes procesit të rekrutimit gjatë vitit 2025, ku janë zhvilluar procedurat e seleksionimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve. Nga gjithsej 4 Avokatë Shtetërorë të paraparë për rekrutim, janë rekrutuar 3, për shkak të kufizimeve buxhetore. Ndërsa, janë angazhuar edhe 2 konsulentë përmes procedurave të prokurimit për të mbështetur funksionimin dhe rritjen e kapaciteteve profesionale të institucionit.

Në këtë drejtim, objektiva është zbatuar, ndërsa proceset e rekrutimit do të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2026, me miratimin e rregullores se re per organizimin e brendshem.

- Avancimi i bazës së të dhënave

Kjo objektive ka paraqitur më shumë sfida në realizim. AVSH ka tashmë në funksion databazën përkatëse, në të cilën bëhet vazhdimisht futja e të dhënave dhe shkresave. Megjithatë, për shkak të numrit të kufizuar të stafit, ende nuk është arritur që të gjitha proceset e punës të mbulohen plotësisht përmes sistemit të databazës. Andaj, kjo rezulton në përpunimin e të dhënave në menyre manuale që paraqet ngarkesë shtesë për stafin në periudha raportuese.

Andaj, mund të konkludohet që kjo objektive nuk është arritur të realizohet.

- Hartimi i Raportit Vjetor

Kjo objektive është realizuar me sukses, pasi është përgatitur Raporti vjetor dhe është dorëzuar tek Kabineti i Ministres në përputhje me afatet përkatëse.

Si përfundim, AVSH gjatë vitit 2025 ka pasur një ngarkesë të theksuar. Nëse bëhet një krahasim i lëndëve të pranuar, shohim se ndër vite Avokatura ka pranuar rreth 4000 lëndë të reja për çdo vit, ndërsa në vitin 2024 dhe 2025 ka pranuar mbi 12000 lëndë, e që ka qenë numër i paparashikueshëm dhe ka shkaktuar ngarkesë të papërballeshme.

Prioritetet për përmirësimin e performancës

Bazuar në të dhënat e Raportit të Performancës së AVSH për vitin 2025, identifikohen disa fusha prioritare që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme me qëllim të përmirësimit të efikasitetit të Avokaturës Shtetërore. Këto prioritate burojnë nga tregues që nuk janë realizuar plotësisht ose janë realizuar vetëm pjesërisht dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e shërbimeve dhe në përmbushjen e misionit të agjencisë.

1. Miratimi i Projekt-Rregullores për organizimin e brendshëm të AVSH-së dhe rekrutimi i stafit të ri:

Pavarësisht përgatitjes dhe finalizimit të dokumenteve përkatëse, miratimi i Projekt-Rregullores nuk është realizuar gjatë vitit 2025 për shkak të rrethanave dhe zhvillimeve që nuk kanë qenë në kompetencë të drejtpërdrejtë të AVSH-së. Në këtë drejtim, miratimi dhe zbatimi i kësaj rregulloreje duhet të trajtohet si prioritet, me qëllim të rritjes së efikasitetit institucional dhe përmirësimit të administrimit të proceseve të përfaqësimit.

Me këtë rregullore parashihet rritja e stafit, e cila pritet të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e performancës, duke marrë parasysh numrin e lëndëve. Me miratimin e saj, prioritet kryesor do të jetë rekrutimi i stafit të ri.

2. Angazhimi i shërbimeve të jashtme në procedura të arbitrazhit

Është e nevojshme të gjendet një zgjidhje ligjore efektive për angazhimin e firmave ligjore ndërkombëtare në rastet e arbitrazhit. Kjo do të mundësonte zhvillimin e këtyre procedurave brenda afateve të përcaktuara ligjore.

3. Avancimi i proceseve të digjitalizimit:

Është e nevojshme të ndërmerren hapa konkretë në nivel institucional dhe ndërinstitutional për hartimin dhe zbatimin e projekteve të digjitalizimit. Kjo do të mundësonte modernizimin e proceseve të punës dhe do të ndikonte drejtpërdrejt në lehtësimin dhe përshpejtimin e punës së stafit të AVSH-së, si dhe në rritjen e efikasitetit të përgjithshëm.

Në përmbyllje, performanca e AVSH për vitin 2025 paraqet një rezultat të balancuar. Institucioni ka dëshmuar angazhim të vazhdueshëm në përmbushjen e detyrave thelbësore dhe në forcimin e bazës ligjore dhe profesionale të funksionimit të tij. Megjithatë, mbeten ende fusha që kërkojnë përmirësim për të siguruar një sistem më efikas, më gjithëpërfshirës dhe më të qëndrueshëm.

Rekomandohet që në vitet në vijim të fokusohet vëmendje e shtuar në:

- Miratimin e Rregullores së brendshme,
- Angazhimin e shërbimeve të jashtme në procedura të arbitrazhit,
- Avancimin e procesit të digjitalizimit.

Zbatimi i këtyre rekomandimeve kërkon bashkëpunim të ngushtë ndërinstitutional, buxhetore dhe teknike. Vetëm përmes një angazhimi të koordinuar dhe të vendosur, mund të sigurohet që AVSH të vazhdojë të luajë një rol kyç në përfaqësimin e institucioneve.

Donika Gërvalla Schwarz

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë në detyrë

